



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

Trupa punuese  
Debat me Publikun

02 Nr. 06-12299 /24

Klinë, me : 08.04 /24

### PROCESVERBAL

Nga Debatimi me Publikun, të mbajtur, më dt. 20.03.2024, me fillim nga ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Debatin e udhëhoqi kryesuesi i trupës punuese, z. Enver Mala, ndërsa të pranishëm ishin drejtorë të drejtorive dhe zyrtar publikë të komunës së Klinës.

### RENDI I DITËS

**1.Hartimi i Draftit të Projekt-Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Komunën e Klinës.**

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ju falënderoj për zëmërsisht për pjesëmarrjen e juaj!

Debat është organizuar me qëllim që t'i mundësohet secilit zyrtar që të debatojmë rreth organizimit të brendshëm dhe sistematizimit të vendeve të punës në Komunën e Klinës. Njoftimi është publikuar më 8 mars në Platformën e konsultimeve publike dhe në uebsaitin e Komunës së Klinës, si dhe zgjat deri më 25 mars 2024, rregullorja, deri në këtë kohë pranohet çdo kontribut i secilit zyrtar. Unë në emër të grupit punues të cilën e udhëhoqi, shprehi mirënjohjen dhe e falënderoj secilin kontribuues, sepse kontributet e juaja do e përmirësojnë cilësinë e kësaj rregulloreje. Trupa punuese hartimin e kësaj projekt rregulloreje e ka bazuar në dispozitat e Ligjit për zyrtaret publik, Nr.08/L-197, Statutin e komunës së Klinës të vitit 2010, Rregulloren për standardet e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën shtetërore dhe agjencive të pavarura, Nr.01/2020, Rregulloren për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil të Kosovës, Nr.04/2024, Katalogun

për titujt e vendeve të punës në shërbimin civil të inkorporuar në Sistemin Hrmis ku kanë qasje vetëm zyrtaret e NJMBNJ-së, sepse këto janë akte ligjore dhe nënligjore të cilat përcaktojnë formën e organizimit dhe mënyrën e funksionimit të institucioneve që kanë të punësuar nëpunës civil

**Arsyejet pse trupa punuese hartimin e draftit të projekt rregullores, e ka bazuar në dispozitat e legjislacionit të cekur me lartë, nder të tjera janë, sepse:**

Ligji për Zyrtaret Publik, Nr.08/L-197, përkatësisht neni 5, zyrtarin publik e ka ndarë në pesë grupe të nëpunësve dhe atë në:

- 1.1. Nëpunësja/i i shërbimit civil;
- 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik;
- 1.3. Krijuesja/i dhe performuesja/i e/i artit dhe kulturës;
- 1.4. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës; dhe
- 1.5. Zyrtarja/i i kabinetit.

Ligji për zyrtarët publikë ka përcaktuar, se ?

Nëpunëses i shërbimit civil konsiderohet zyrtarja/i publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin apo zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunëse/ës statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunëse/ës i shërbimit civil, me ligj të veçantë.

Nëpunëses i shërbimit publik konsiderohet zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike.

Krijuesja/i dhe performuesja/i i artit dhe kulturës konsiderohet zyrtarja/i publik që ushtron profesionin e saj/tij artistik në një institucion të artit apo të kulturës

Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës konsiderohet zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike.

Zyrtarja/i i Kabinetit konsiderohet zyrtarja/i publik, që ushtron detyrën në Kabinetin e kryetarit p.sh.

Statuti i komunës së Klinës, ka përcaktuar mënyrën e organizimit të administratës në Komunën e Klinës, si dhe ka specifikuar detyrat dhe përgjegjësit e secilës drejtori.

Rregullorja për standardet e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën shtetërore dhe agjencive të pavarura, Nr.01/2020, përkatësisht neni 5, paragrafi 5 ka përcaktuar se për të funksionuar si divizion, sektor, zyre apo njësi, duhet këtë të paktën tre (3) nëpunës që kryejnë funksione të së njëjtës fushë, njëri prej tyre është udhëheqës i divizionit, sektorit, zyrës apo njësisë dhe dy nëpunës janë vartës të tij (pozita profesionale).

Rregullorja për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës, Nr.06/2024, përkatësisht neni 4, Pozitat e punës për nëpunësit e shërbimit civil, i ka ndare në :

- 1.1. kategoria e lartë drejtuese, ku bëjnë pjesë sekretaret e përgjithshëm në nivel qendror;
- 1.2. kategoria e mesme drejtuese, ku bëjnë pjesë Drejtoret e departamenteve në nivel qendror ;
- 1.3. kategoria e ulët drejtuese, ku bëjnë pjesë udhëheqësit e Divizioneve, sektorëve etj. në nivel qendror dhe lokal;
- 1.4. kategoria e specialistëve- zyrtaret që kanë titullin Zyrtar i Lartë nga fushat deficitare;
- 1.5. kategoria profesionale;

Rregullorja Nr.06/2024 ka përcaktuar së detyrat dhe përgjegjësitë kryesore janë ato detyra dhe përgjegjësi tipike të klasës përkatëse, apo ato tipare dalluese në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi që e dallojnë atë klasë nga një klasë në tjetër të shërbimit civil brenda kategorisë, si dhe klasifikimi i pozitave bëhet duke u bazuar në rëndësia e pozitës, lirin e vendimmarrje dhe vështirësinë e funksionimit.

Po ashtu, ka përcaktuar së specialist do të kategorizohet zyrtari i cili mban pozitën e nivelit të lartë profesional me përgatitje specifike, të cilat kryejnë detyra që kërkojnë njohuri të thella profesionale, të natyrës komplekse ose specifike në mënyrë individuale ose si udhëheqës ose anëtar i një ekipi, si dhe punojnë të pavarur dhe pa mbikëqyrje dhe mbështetje profesionale brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektivat dhe afatet e përfundimit të detyrave. Zyrtari i cili kategorizohet të kategoria specialit, kryen detyra të cilat ndikojnë në punën e njësisë organizative. Kontribuojnë dhe kontrollojnë vendimmarrjen që si rregull ka pasoja kombëtare por përfshin edhe raste individuale. Kryerjen detyra dhe përgjegjësi në përputhje me udhëzimet e përgjithshme të udhëheqësit të tij dhe me një shkallë të konsiderueshme autonomie dhe vetë-iniciative. Kryejnë pune që paraqesin kompleksitet të lartë dhe nevojë për inovacion, si dhe mbështetjen profesionale për nëpunësit civil të nivelit më të ulët dhe mbikëqyrësit e tij në çështjet brenda fushës së përgjegjësisë së tij.

Ka përcaktuar së në Profesional 1 do të kategorizohet zyrtari i cili mban pozitën e nivelit të lartë profesional me përgatitje specifike, të cilat kryejnë detyra që kërkojnë njohuri të thella profesionale në fushat dhe sektorët e caktuar, të natyrës komplekse ose specifike në mënyrë individuale ose si udhëheqës ose anëtar i një ekipi, si dhe punojnë të pavarur dhe pa mbikëqyrje dhe mbështetje profesionale brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektivat dhe afatet e përfundimit të detyrave. Zyrtari i cili kategorizohet të kategoria profesionale 1, kryen detyra të cilat ndikojnë në punën e njësisë organizative. Kontribuojnë dhe kontrollojnë vendimmarrjen që si rregull ka pasoja kombëtare por përfshin edhe raste individuale. Kryerjen detyra dhe përgjegjësi në përputhje me udhëzimet e përgjithshme të udhëheqësit të tij dhe me një shkallë të konsiderueshme autonomie dhe vetë-iniciative. Kryejnë pune që paraqesin kompleksitet të lartë dhe nevojë për inovacion, si dhe mbështetjen profesionale për nëpunësit civil të nivelit më të ulët dhe mbikëqyrësit e tij në çështjet brenda fushës së përgjegjësisë së tij.

Ka përcaktuar së në Profesional 2 do të kategorizohet zyrtari i cili mban pozitën e nivelit profesional në gjithë shërbimin civil, të cilat kryejnë detyra që kërkojnë njohuri të përgjithshme profesionale në fusha të caktuara, brenda udhëzimeve specifike dhe praktikave të institucionit me një shkallë të arsyeshme të pavarësisë me mbikëqyrje dhe mbështetje profesionale të kohëpaskohshme nga mbikëqyrësi dhe zyrtari i nivelit profesional më i lartë profesional. Zyrtari i cili kategorizohet të kategoria profesionale 2, kryen detyra të cilat ndikojnë në punën e njësisë organizative. Kontribuojnë dhe kontrollojnë vendimmarrjen që si rregull ka pasoja kombëtare por kufizohet në pasoja brenda institucionit. Kryerjen detyra nën mbikëqyrje të zakonshme, jo të rregullt për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë duke ndjekur udhëzimet e

përgjithshme dhe specifike të eprorit/mbikëqyrësit. Kryejnë punë që paraqesin kompleksitet të mesëm dhe nevojë për inovacion.

Ka përcaktuar së në Profesional 3 do të kategorizohet zyrtari i cili mban pozitat e e nivelit profesional në gjithë shërbimin civil, të cilat kryejnë detyra administrative, mbështetëse për zyrtarët e tjerë profesionale. Punën e kryhen brenda udhëzimeve, procedurave të cilat janë të detajuara dhe në mbikëqyrjen e eprorit ose zyrtarit të nivelit të lartë profesional. Kryen detyra rutinë që kërkojnë zbatimin e metodologjisë së përcaktuar të punës, procedurave dhe teknikave profesionale.

Ka përcaktuar së klasifikimi i një pozite si pjesë e një grupi të detajuar mbështetet në përshkrimin e vendit të punës. Se pozita klasifikohet në grupin e detajuar me të cilin korrespondon fusha e arsimit të kërkuar për atë pozitë, sipas përshkrimit të punës dhe klasën përkatëse dhe jo sipas fushës së arsimit të cilën e ka mbajtësi i arsimit.

Katalogu për titujt e vendeve të punës në shërbimin civil ka përcaktuar emërtimin e pozitës, kategorinë, klasën, grupin dhe kriteret e përgjithshme, si dhe përshkrimin e vendit të punës për çdo pozitë.

Rregullorja pas miratimit nga ana e kuvendit komunal, duhet të dërgohet për shqyrtim të ligjshmërisë, në MAPL (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal). MAPL-ja nuk ka juridiksion me vlerësuar ligjshmërinë e përputhshmërisë së titujve të vendeve të punës të parapara në këtë rregullore me katalogun për titujt e vendeve të punës në shërbimin civil, prandaj brenda afatit të përcaktuar më dispozita të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ajo e dërgon tek DMZP-ja ( Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë), më qëllim që ky institucion të shqyrtoj përputhshmërinë e titujve të parapara në këtë rregullore me Katalogun për titujt e vendeve të punës në shërbimin civil, rregulloren për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil, rregulloren për standardet e organizimit të brendshëm dhe sistematizimit të vendeve të punës në administratën shtetërore. Nëse konstaton që neve këtë rregullore nuk e kemi hartuar në përputhje me aktet e lartpërmendura nuk e jep ligjshmërinë e këtij akti, pra, e kthen përsëri në shqyrtim tek kuvendi komunal. E njëjta do të dërgohet edhe tek Ministria e Financave për shqyrtimin e ligjshmërisë në aspektin financiar. Pikërisht kjo ka qenë arsyeja pse ne nuk kemi mundur të shtojmë numra të zyrtareve qysh ka pasur kërkesa, për shembull me parashikuar, pastaj nëse kemi mundësi buxhetore me zhvilluar procedurën e rekrutimit për plotësimin e atyre pozita, por kemi qenë të detyruar të cekim numrin e nëpunësve të lejuar me ligjin për buxhet për vitin 2024, sepse po të vepronim ndryshe neve as ky institucion nuk do jep ligjshmërinë kësaj rregulloreje. Andaj, neve gjatë hartimit të kësaj rregulloreje kemi qenë të detyra t'iu përmbahemi këtyre rregullave, në të kundërtën puna e jonë do shkonte huqë.

Me qëllim që rregullorja të jetë plotësisht e harmonizuar me dispozitat e legjislacionit në fuqi, pra, që procesi të mos dështojë, në cilësinë e kryesuesit të trupës punuese me dt.02.02.2024 përmes emailit ju kam drejtuar Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (DMZP) dhe kam kërkuar të më jepet mendim këshillimor rreth përmbajtjes së draftit të projekt rregullores. DMZP-ja me dt.11.02.2024, më ka kthyer përgjigje, përmes së cilës m'i ka dhënë disa rekomandime sa i përket organizimit, të cilat ne domosdoshmërisht duhet t'ju përmbahemi, p.sh., na kanë sugjeruar të formohet sektori ligjor, mos të ketë zyrtarë ligjor nëpër njësi të ndryshme, pra, ky shërbim të koncentrohet vetëm në një njësi për shkak të llogaridhënies p.sh në rast se komuna dështon në aspektin juridik atëherë të kërkohej llogaridhënie nga personi përgjegjës që udhëheq atë sektor. Pra, udhëheqësi i këtij sektori duhet të japë llogari pse

s'ka ndërmarrë masa të cilat janë paraparë në Ligjin për zyrtarë publikë, ndaj zyrtarëve nën vartësi të tijë. Ndryshimet janë bërë konformë rekomandimeve të DMZP dhe pastaj projekt rregullorja është ven në konsultim publik. Këtë shkresë mund të vini në zyrën e NJMBNJ dhe ta shikoni kur të doni.

Trupa punuese rregulloren e ka hartuar duke u bazuar në dispozita lartpërmendura dhe qëllimi kryesor i trupës t'cilën unë e udhëheq është të mos kemi probleme me kalimin e ligjshmërisë dhe që zyrtari i komunës tonë, pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje të trajtohet i barabartë me zyrtaret tjerë nëpër institucionet tjera shtetërore, pra, të merren pagë të njëjta për punën e njëjtë. Ata që e kanë lexuar draftin e kësaj rregulloreje kanë vërejtur, se në këtë rregullore askund nuk e kemi cekur koeficientin, sepse kompetencën për caktimin e klasës së ekuivalencës (koeficientin) sipas vendimit të datës 16.02.2023 Nr 04/128 të nxjerr nga kryeministri i Republikës së Kosovës ja ka dhënë DMZP-së në bashkëpunim me thesarin, përmes formimit të komisioneve të përbashkëta, pra, vetëm këto dy organe kanë kompetencë të caktuar klasën e ekuivalencës së pagës për secilën pozitë, andaj, në nivel komunal nuk e kemi këtë të drejtë, prandaj edhe nuk e kemi caktuar koeficientin për asnjë pozitë në këtë rregullore, por vetëm klasën e pagës. Unë e bëra një prezantim të shkurtër, a keni diçka për të shtuar ju anëtarë tjerë të komisionit? Nëse jo, atëherë fillojmë me debat publik.

Fjalën ja jepim, znj. Vlora Tafili?

**Vlora Tafili, zyrtare për Informim:** Përshëndetje për të gjithë, i nderuar kryesues i komisionit, veçanërisht për gjithë bashkë kolegët e mi që kemi vuajtur me vite!

Sa i përket sistematizimit dhe koeficienteve, çështja e parë që desha të ndërlidhem me rregulloren është që sa i përket rregullores, shoku, Enver, tjetër herë ja shton edhe shkurtesat dhe nocionet, e para se nuk e kuptova se në çka i bie edhe shkurtesat që nuk është shumë me i marr *copy-paste* prej ligjit çka është zyrtari publik, çka parasheh kategoria, e dyta, unë jam ndalur vetëm te zyra për informim edhe e kisha bërë një propozim, unë si Vlorë, po në fakt tash po flas nga sektori për informim, propozoj që zyra për informim të transferohet në kuadër të zyrës së kryetarit, ashtu siç i kanë 80% të komunave. Sa i përket zyrës për informim, i pash disa përgjegjësi që janë totalisht në kundërshtim me punën që kryej unë edhe t'u kisha lutur që m'u specifikuar sa më shumë sa i përket detyrave për mua, si Vlorë, si zyrtare po edhe për bashkë kolegët e mia, kjo shoqëron përfaqësuesit e mediave brenda komunës edhe regjistron deklaratat e zyrtarëve komunalë, në qoftë se ekziston mundësia me e fshirë, se unë nuk e shoqëroj askënd nëpër komunë. Nëse dëshirojnë të vijnë mediat, mirë, nëse nuk dëshirojnë të vijnë, është përgjegjësi e tyre. Sa i përket kërkesave për qasje në dokumente publike dhe përgatit raportin mbi zbatimin e Ligjit për qasjen e dokumenteve publike, nuk e di a duhet të shqyrtohet kjo përgjegjësi karshi Ligjit për qasje në dokumente publike, sepse ai Ligj specifikisht nuk thotë që zyrtari për informim duhet ta ketë këtë përgjegjësi, ai thotë që zyrtari përgjegjës për qasje në dokumente publike mund të jetë secili zyrtar brenda administratës së institucionit përkatës, edhe pjesa tjetër, ajo që desha të përfshihem menjëherë unë në diskutim të ti, Enver, unë si Vlorë e kam pasur një kërkesë që Zyrës për Informim të ju shtohet një zyrtare e re. E the më herët që kjo nuk varet prej kësaj rregullore komunale, por, po më intereson kjo Drejtoria për Administratë, në qoftë se ka ekzistuar mundësia me dal zyrtar i lartë për barazi gjinore edhe zyrtar për barazi gjinore, se krejt komuna e dinë që tek ne është veç një zyrtare për barazi gjinore, kah ka lindur ky zyrtari i lartë për barazi gjinore edhe ata dytë i kanë profesional 1 kategorizimet? Dalim te sektori për informim, drejtues të ultë, profesional 2, profesional 2, duke na bashkangjitur edhe zyrtarin

për përkthime dhe zyrtaren për lektorim, a mund të bëhemi një njësi? Dhe pyetja e dytë, profesional 2shi, si ekziston kategoria që ky zyrtar i lartë për barazi gjinore me u bërë profesional 2?

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Fillimisht të falënderoj për pyetjen!

Sa i përket shkurtesave e ke te neni 3 i rregullores, ku decidivisht saktësohet se fjalët dhe shprehjet e tjera të përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në Ligjin numër 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) numër 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Vlorë, nëse e ke lexuar e kishe parë, ose nëse nuk e ke lexuar, e lexon tash e tutje edhe e sheh se fjalët dhe shprehjet e tjera të përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në Ligjin numër 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) numër 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil. Sa i përket pozitës së zyrtares për barazi gjinore është gabim teknik, se nuk është profesional 1 po është profesional 2. Ky gabim teknik do të përmirësohet në draftin final të kësaj rregulloreje. Pozitës për barazi gjinore DMZP-ja dhe Thesarija, ja kanë caktuar ekuivalencën e klasës së pagës të nivelit profesional 1, këtë koeficient e gëzon që nga maji shkurt 2023, prandaj neve si trup punues nuk guxojmë asnjëherë me e dëmtuar nëpunësen në fjalë, dhe asnjë nëpunës tjetër sa i përket pagës, sepse ekziston një aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese, i cili thotë decidivisht se nuk lejohet ulja e pagës, prandaj me qëllim të respektimit të vendimit të DMZP/Thesar dhe aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, në këtë rregullore e kemi paraparë pozitën zyrtar i lartë për barazi gjinore. Kështu më ka rekomanduar DMZP-ja të veprojë përmes opinionit të datës 11 shkurt 2024.

**Vlora Tafili, zyrtare për Informim:** Veç mos të keqkuptohemi, se unë nuk pata asgjë kundër profesional 1shit, çështja që më interesoj më së shumti: a janë dy zyrtare për Barazi Gjinore me këtë klasifikim, apo nuk janë?

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Po në rregullore e kemi paraparë më qenë dy zyrtar aty, pra me qenë zyrtari i lartë për barazi gjinore dhe zyrtari për barazi gjinore, përndryshe s'kishin figuruar, nuk janë për momentin, por është propozuar të bëhen. Organizimi brenda drejtorisë është i lirë, pra drejtorja ka të drejtë të organizohet ashtu siç ajo mendon se funksionon më mirë. Në rastin konkret nuk shtohet numri i përgjithshëm i të punësuarve dhe si rrjedhojë nuk ka implikim buxhetor, sepse është menduar në atë pozitë pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, nëse miratohet sipas formatit të propozuar nga trupa punuese të transferohet njeri nga zyrtaret ekzistues (aktual).

**Vlora Tafili, zyrtare për Informim:** Do të thotë, pas miratimit të rregullores ne do t'i kemi dy zyrtare për Barazi Gjinore.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Patjetër, nëse nuk do të këtë ndryshime pas konsultimi publik.

**Vlora Tafili, zyrtare për Informim:** Në rregull, specifikisht edhe qartë le të shkruhet në procesverbal, që si Vlorë, kam kërkuar që të shtohet një zyrtare për Zyrë të Informimit, ashtu si qenka shtuar edhe atje.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Në rregull, dëshira ime është që edhe në Zyrën e Personelit me qenë 5 zyrtarë, po mundësitë buxhetore janë me qenë vetëm 3. Megjithatë kërkesa e juaj pas përfundimit të procesit të konsultimit publik do të shqyrtohet dhe nëse ka bazë do të aprovohet. Ndërsa sa i përket klasifikimin në sektorin për informim, katalogu fatkeqësisht nuk e lejon me e pasur zyrtarin e lartë për Informim, këtui është esenca. Kështu ka përcaktuar Katalogu për titujt e vendeve të punës në shërbimin civil dhe neve nuk mundemi të veprojmë në kundërshtim me katalogun, por duhet të veprojmë ashtu siç ka përcaktuar katalogu për titujt e vendeve në shërbimin civil, i cili për momentin nuk është publik po është inkorporuar në sistemin HRMIS në të cilin unë edhe Xhaviti kemi qasje, kushdo mund të vijë te ne në zyrë edhe t'i konstatojë të gjitha. Arsyejet pse në sektorin për informim janë të parapara pozita e përkthyesit dhe ajo e lektorimit është sepse ato dy pozita kryejnë punë që ndërlidhen me detyrat që kryejnë pozitat e zyrtareve për informim p.sh deklarata e sektorit për Informim para se të postohen, duhet të lekturohen dhe përkthehet. Që lektorim dhe përkthimi të bëhet pa humbur kohë, trupa punuese ka propozuar këto pozita të funksionojnë brenda një sektori të përbashkët. Kështu, ju jeni në kontakt të drejtpërdrejtë.

Nëse nuk ke për të shtuar diçka, ja japim fjalën drejtorit, z. Ilir Bacaj.

**Ilir Bacaj, drejtor i Qendrës për Punë Sociale:** Atëherë, përshëndetje për të gjithë! Unë jam Ilir Bacaj, drejtor i Qendrës për Punë Sociale në Klinë! Përshëndetje komisionit, nuk e di sa anëtarë keni qenë në komision, 5 apo 3 apo 7, këtui jeni veç 3. Realisht kjo është një vërejtje për anëtarë të komisionit, se janë shumë jo serioz në mospjesëmarrje, megjithatë komisioni është dashur të jetë i kompletuar se është siç e tha Vlora një rregullore bukur e vlefshme për zyrtarët publikë që janë të angazhuar në komunën e Klinës. Po ashtu, ishte dashur të jetë minimalisht edhe drejtori i Administratës këtui, sepse diskutohet për administratën e komunës. Unë e falënderoj Enverin që është pjesë e ekzekutivit këtui i vetmi, megjithatë ishte dashur të jenë edhe tjerët, pastaj anëtarët e komisionit, unë e falënderoj udhëheqësin e komisionit që ka ardhur, dhe është takuar me mua si përfaqësues i institucionit, po është dashur realisht të vijnë edhe anëtarët tjerë, të marrin informacione lidhur me organizimin e institucionit të cilin e menaxhoj unë. Unë, vërejtjet e mijja, rekomandimet i kam dhënë edhe në formë të shkruar. Besoj i keni pranuar në lidhje me sistematizimin e vendeve të punës në Qendrën për Punë Sociale. Realisht, nuk kam vërejtje të mëdha për pozicionet të cilat janë paraparë në Qendrën për Punë Sociale, ngase konsideroj se janë edhe në kundërshtim me ligjet aktuale që janë të zbatueshme në institucionin tonë. Ne e dimë se ligjet janë mbi rregulloret, unë e kuptoj që ju rregulloren e keni bërë mbi bazën e ligjeve të cilët ju atakoheni si zyre, mirëpo është dashur të merren parasysh edhe ligjet e zbatueshme nëpër institucione ku ofrohen shërbime për qytetarë të komunës, e para, Ligji për Shërbime Sociale dhe familjare, përkatësisht neni 52, po flasim tash për pozicionet që janë paraparë në Qendër Sociale, këto e dhanë vërejtjen më herët për koeficientin po nuk po dua me u lëshuar në ato edhe nuk dua të mendoj që kjo rregullore është duke tentuar të aprovohet me tentim të legjitimitetit dhe ndryshimit të koeficienteve që janë bërë me herët. Nuk jam kundër askujt që janë rritur koeficientet, realisht po të kisha mundësi, edhe ju po të kishit mundësi, gjithsecilit ja kishit rritur pagën, po realisht ka pasur dallime tek punëtorët, ka pasur reagime, ka shqetësime të mëdha të cilët gjithsecilit prej jush ju kam thënë po na kanë thënë edhe neve, nuk dua të ndalem në ato, edhe tjetra, ndoshta nuk është mirë se zakonisht unë përcjella me vëmendje e në njëfarë forme e projedikuat vendimin përfundimtar duke thënë që edhe nëse ne e aprovojmë ndryshe në kuvend, legjitimiteti i ligjshmërisë ka me u kthyer mbropa, dmth ne nuk e

dimë a kthehet a s'kthehet, tek e fundit, në rregull atëherë pse shkon me një instancë tjetër për legjitimitet përderisa ne e dimë, nëse ne themi se nëse shkon ndryshe, kthehet, atëherë s'paska arsye as për të shkuar atje.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Rregullorja për klasifikimin e vendeve të punës 06/2024, shumë qartë e ka precizuar se në nivelin lokal pozita më e lartë që i takon nëpunësit civil është udhëheqës i sektorit.

**Ilir Bacaj, drejtor i Qendrës për Punë Sociale:** Unë e arsyetova këtë se ju jeni të varur prej listës së rregullores që funksionon ju si zyre.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Edhe unë jam plotësisht i pajtimt se ju jeni të dëmtuar.

**Ilir Bacaj, drejtor i Qendrës për Punë Sociale:** Në rregull jemi, po a di si po i bie kjo? Kjo po i bie se diskutimi publik është kot fare, nëse ne na thua, nuk bën kjo, nuk bën kjo, edhe këto nuk futen fare në rregullore, atëherë cila është domethënia e debatit publik, cila është domethënia e shprehjes së mendimeve të rekomandimeve të njerëzve që përfaqësojnë institucionet të zyrtarëve publikë që punojnë në komunë? Kjo i bie me sa unë po kuptoj, ky debat është bërë, rekomandimet jepen po këto s'do të përfshihen fare në rregullore, rregullorja nuk do të pësojë ndryshime fare edhe e njëjta do të shkojë në kuvend, e për të cilën unë mendoj dhe shpresoj që kjo rregullore kështu shpresoj që nuk do të kalojë në kuvend, e para unë mendoj që kjo rregullore është për herë të parë duke u bërë në komunë, unë kam kontaktuar në komuna tjera, në asnjë komunë tjetër nuk është iniciuar procedurë për këtë rregullore, dmth asnjë komunë nuk e ka ende rregulloren, po ndoshta nuk është dashur ne ta bëjmë të parët, se zakonisht kur ngutemi me bërë të parët, mundësia për të gabuar është më e madhe, si ka ndodhur herëve tjera. Ne këtu po jetojmë, e dimë që shumë herë kanë gabuar institucionet në komunë qysh prej pasluftë, edhe me vendime edhe me rregullore, por po ndalemi te Qendra për Punë Sociale, e thash, Ligji për Shërbime Sociale, ligj bazik që punon Qendra për Punë Sociale, ne këtu e kemi edhe Enverin i cili ka qene drejtor i Qendrës edhe fort mire edhe ky e di se si funksionon Qendra për Punë Sociale. Ligji për Shërbime Sociale që është aprovuar në janar të këtij viti, neni 52, specifikisht e konsideron Qendrën për Punë Sociale si institucion publik edhe e cek se Qendra për Punë Sociale menaxhohet nga drejtori i Qendrës për Punë Sociale, dmth ky Ligj, Ligji i Shërbimeve Sociale që është aprovuar në kuvend të Kosovës, e njeh pozicionin e drejtorit, e njeh institucionin e Qendrës për Punë Sociale, sepse ka vula, ka statut edhe pra në përbërje të tij i njeh edhe dy sektorë: të Shërbimeve Sociale dhe të Asistencës Sociale, që i bëjnë punët e ndryshme, nuk janë punë të njëjta, shërbimi social, ne e dimë që merret me shërbime profesionale, jep mendime për adoptim të fëmijëve, një menaxher i rastit nuk mund të jetë me profesional 2, përderisa ti e the më herët se në profesional 1 kategorizohen zyrtarët të cilët marrin edhe vendime, kane liri të plotë në vendime, pikërisht punëtorët social në Qendër për Punë Sociale kane liri të plotë të vendimit, ngase japin mendime për besueshmëri të fëmijëve, japin mendime për adoptim të fëmijëve, për kujdestari, për strehim familjar, për dhunë në familje, dërgojnë raporte për prokurori, për gjykatë, për polici, dmth e kanë autonominë, tjetra, punëtorët social brenda janë të licencuar, e licencën e marrin çdo tre vite për t'u ushtruar profesionin e punëtorit social, dmth janë punëtorë profesional të licencuar, nuk guxojnë të dërgojnë raport nëse kalon afati i licencimit. Unë këto që po i them, ju mund t'i shihni si të kundërligjshme me aspektin ligjor çfarë ju punoni si zyre e Personelit. Prapë ju kuptoj unë juve, ju ndikoheni prej qeverise, ndërkaq ne jemi të obliguar me i thënë preokupimet tona si

institucion. E thash, asistenca sociale për shërbime sociale, e tregova çfarë pune bëjnë, asistenca sociale nuk ka të bëjë fare me shërbime sociale, asistenca sociale u ofron ndihme financiare familjeve në nevojë, dmth është aspekti financiar që ju ndihmon me ndihmë materiale, janë shërbime të ndryshme brenda Qendrës për Punë Sociale.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Nëse bën këtu të ndërhyj veç pak, ju e dini fort mirë, momentin që e kam pranuar opinionin nga DMZP-ja, kam qenë te ju në zyre, e kemi diskutuar pikërisht këtë çështje edhe jemi dakorduar për të vepruar ashtu si jemi marr vesh, edhe ashtu si jemi marr vesh unë e kam shkruar në rregullore. Çka ndodhi pastaj, unë nuk e di, por i paske rënë pishman!

**Ilir Bacaj, drejtor i Qendrës për Punë Sociale:** Jo, nuk është kjo që u bëra pishman!

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Në takimin që kemi mbajtur në zyrën e juaj shumë çartë, ta kam shpjeguar, se në mendimin (rekomandimin) që kam pranuar nga DMZP-ja është cekur se Qendra për Punë Sociale, sektori për Mirëqenie Sociale, sektori për Shërbime Sociale, kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë të cilat janë të ngjashme apo të përafërta, andaj jemi dakorduar të veprojmë sipas mendimit të DMZP-së, pra, të lejmë vetëm Qendrën për Punë Sociale.

**Ilir Bacaj, drejtor i Qendrës për Punë Sociale:** Po ne e kundërshtojmë këtë, ne kemi të drejtë ta kundërshtojmë këtë si institucion.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Prandaj, shpërndarja e detyrave dhe përgjegjësive të sektorit duhet të bazohet në funksion dhe të mos jenë të ngjashme, unë kam kërkuar të m'i siguron detyrat.

**Ilir Bacaj, drejtor i Qendrës për Punë Sociale:** Po, t'i kam siguruar detyrat, t'i kam dërguar.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** M'i ke dërguar, po m'i ke dërguar detyrat e njëjta apo të përafërta.

**Ilir Bacaj, drejtor i Qendrës për Punë Sociale:** Jo, detyrat e njëjta nuk t'i kam dërguar, t'i kam dërguar edhe të asistencës sociale edhe të shërbimeve.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Ilir, Qendra për Punë Sociale e ka statutin e vet. Neni 13 ndër të tjerat ka paraparë që Këshilli i Ekspertëve ka të drejtë me nxjerr rregullore për organizimin e brendshëm me propozim të drejtorit, atëherë luteni ti drejtoni këtij Këshilli dhe të kërkonin nga ata të nxjerr rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në QPS. Është shumë më rëndësi me ditë së nëpunësit e Qendrës për Punë Sociale, nuk e gëzojnë statusin e veçantë të nëpunësit civil, andaj sa i përketë klasifikimit të pozitave në këtë institucion, ato duhet të bëhen sipas dispozitave ligjore të lartpërmendura dhe jo dispozitave të ligjit të veçantë.

**Ilir Bacaj, drejtor i Qendrës për Punë Sociale:** Dëgjo, Ligji për Shërbime Sociale që ka hyrë në fuqi në janar, specifikisht na njofton edhe propozimet me anë të qendrës sociale, decitivisht thuhet se ministria në kuadër të qeverisë, pas aprovimit të vitit me akt nënligjor do organizojë punën e brendshme të Qendrës për Punë Sociale, dmth ne jemi duke u ngutur me rregulluar brenda institucionit, se jam i sigurt se nuk kalon as muaji shtator edhe na vjen shkresa prej ministrisë, akti nënligjor e ka të rregulluar çështjen, se kjo specifikohet me ligj.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Nëse miratohet akti nënligjor nga Ministria e Financave dhe ai parasheh struktura tjetër organizative, e merr atë akt nënligjor edhe e shfrytëzon nenin 13 të statutit të Qendrës për Punë Sociale dhe e krijon një rregullore të brendshme, ashtu qysh thotë neni 13. Deri atëherë, ne nuk kemi kohë të presim për arsye se kemi afatin tremujor për të përfunduar procesin e sistematizimit, pra, për të miratuar rregulloren e brendshme. Rregullorja nr.06/2024, ka hyrë në fuqi më 28 shkurt, pra neve duhet të përfundojmë procesin e sistematizimit masë voni deri më dt. 28 maj.

**Ilir Bacaj, drejtor i Qendrës për Punë Sociale:** Pse s'po bëhesh i sinqertë, nëse ti e kategorizon Qendrën për Punë Sociale si sektor, atëherë qysh mundemi ne me nxjerr rregullore të brendshme kur rregullorja që aprovohet në kuvend bëhet për gjithë zyrtarët komunalë që punojnë në Qendrën Sociale, edhe kjo është e padrejtë me ma thënë, se ti mundesh me thënë mundet me u ndryshuar prapë kjo rregullore. A mund tua bëj një pyetje juve, si komision: Për çka organizohet ky debat?

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Për t'i dëgjuar dhe për t'i shpjeguar procedurat.

**Ilir Bacaj, drejtor i Qendrës për Punë Sociale:** Jo, debatet publike, rekomandimet e njerëzve që i japin këtu, ju duhet ta gjeni mundësinë për t'i përfshirë në rregullore, e keni obligim.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Nëse rekomandimet, sugjerimet kanë bazë ligjore, neve do ti marrim parasysh dhe ato do të përfshihen në draftin final. Unë jo rastësisht e thash në fillim të debatit edhe gjatë prezantimit, se hartimi i rregullores është bazuar në bazë në dispozitat e Ligjit për zyrtar publik, statutit të komunës, rregullores për standardet e organizimit të brendshëm dhe sistematizimit të vendeve të punës në administratën shtetërore, rregullores për klasifikimin e vendeve të punës, sepse këto janë baza kryesore që në punojmë me to dhe në bazë të tyre e bëjmë klasifikimin e pozitive, pra, në nuk punojmë me ligje të veçanta, sepse ligji i veçantë rregullon organizimin, klasifikimin e pozitive në institucionet ku nëpunësit e vll kanë statusin e nëpunësit e vll të veçantë.

**Ilir Bacaj, drejtor i Qendrës për Punë Sociale:** Unë besoj rekomandimet siç janë i keni marr në formë të shkruar, unë i kam sjell edhe në formë fizike, është mirë me i marr anëtarët e komisionit, me shqyrtuar, nëse e shihni të arsyeshme i përfshini jo të gjitha, por i keni edhe nenet edhe ligjet ku janë bazuar, është mirë me i shtjelluar.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Jo vetëm propozimet e juaja po secilin propozim që ka ardhur pas datës 25, fillimisht do të shqyrtohen nga komisioni dhe pastaj do të takohemi edhe me përfaqësuesit e DMZP-në dhe do të marrim edhe mendimin e tyre lidhur me rekomandimet e pranuar.

**Ilir Bacaj, drejtor i Qendrës për Punë Sociale:** Edhe këto reagime ndoshta nuk është mirë me kuptuar se janë nga ana juaj tendencioze si komision, absolutisht, unë nuk e marr se këto janë tendencioze se ju tek e fundit nuk e keni inat. Po e rëndësishme është që edhe ju si komision se ju e keni përgjegjësinë, unë e kuptoj, e keni përgjegjësinë se gjithsecili e drejton gishtin nga ju, me pasur mundësinë që kjo rregullore me u bërë në të mirën e punonjësve të institucionit se tek e fundit edhe ju jeni pjesë e saj.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Shiko, kryetari i komunës e ka themeluar grupin punues të cilën ka rastisur unë me udhëheq, qëllimi im kryesor është në fund të procedurës ky besim të shpërblehet

më anën e ligjshmërisë të kësaj procedure, tjetër qëllim nuk kam. Po të kisha mundësi, asnjë zyrtar publik nuk e kisha lënë nën profesional 1, po mundësitë janë këto që janë. Jam plotësisht i vetëdijshëm që pas përfundimit të këtij procesi do të këtë zyrtar të pakënaqur, unë ata i sugjeroj ti shfrytëzojnë mjete juridike, pra, ti drejtohen Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Veç një gjë dua të sqaroj, trupa punuese nuk shqyrton ankesa, i shqyrton kërkesat që kanë të bëjnë me përmirësimin dhe cilësinë e përmbajtjes së rregullores, mos na merrni si objekt i shqyrtimit të ankesave, në secilin propozim, rekomandim apo koment, ju garantoj së me seriozitetin ma të madhin do ti shqyrtojmë. Unë për zemërsisht secilin prej juve që kini dhënë kontribut në përmirësimin e përmbajtjes së kësaj rregullore ju falënderoj. Po, Skender Behramaj?

**Skender Behramaj, zyrtar i Komunës:** Përhëndetje të gjithëve, fillimisht ju falënderoj që na keni ftuar ta dëgjojmë edhe zërin tonë! I nderuar kryesues i ekipit për hartimin e kësaj projekt rregulloreje për sistematizimin e organizimit e brendshëm, mendimet e mija personale, vërejtjet, sugjerimet për plotësimet e ndryshimeve unë do t'i dërgoj me shkrim. Ndërkaq, sot këtu kam ardhur që të flas edhe në emër të dy kolegëve të mi të cilët punojmë në zyre, dhe konkretisht.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Shiko, Skender, vetëm për vete ke të drejtë të flasësh, për askënd tjetër s'ke të drejtë të flasësh.

**Skender Behramaj, zyrtar i Komunës:** Nuk e di me çfarë rregullore e përcakton që të mos flas!

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Fillimisht, nëse e ke lexuar njoftimin, aty thotë duhet me u deklaruar në cilësi, ti nuk je udhëheqës i sektorit për punë të Kuvendit, prandaj, nuk ke të drejtë të flasësh në emër të sektorit, ti mund të flasësh si zyrtar, Skender Behramaj.

**Skender Behramaj, zyrtar i Komunës:** Po flas jo si zyrtar atëherë. Unë kisha planifikuar shumëçka të flas sot në lidhje me sektorin ku unë punoj si shërbyes civil, nuk jam udhëheqës i sektorit, megjithatë e drejta e fjalës është debat publik edhe unë do të flas. Atëherë, në lidhje me sektorin ku unë punoj dhe shërbej, te neni 16, sektori për punë të kuvendit, detyrat dhe përgjegjësitë e sektorit për punë të kuvendit që në piken e parë ku thotë: misioni i sektorit për punë të kuvendit është ofrimi i shërbimeve profesionale tekniko administrative për kuvendin komunal të komunës së Klinës dhe trupave të tij, që në piken e parë ne e propozojmë që të bëhet një ndryshim, një plotësim, sepse sipas statutit të komunës, neni 9, organet e komunës janë dy; është kuvendi i komunës si organi më i lartë përfaqësues legjislativ dhe vendimmarrës i komunës, dhe 2 është kryetari i komunës si organi më i lartë ekzekutiv i komunës. Pra, neni 9 te organet e komunës, thuhet decitivisht *kuvendi i komunës* edhe në vazhdim të statusit të komunës dhe në çdo dokument tjetër zyrtar. Askund nuk i referohet, *kuvendi komunal*, por vetëm, *kuvendi i komunës*. Tek pika 2.1 e sektorit, neni 16 i sektorit për punë të kuvendit, thotë: Bën njoftimin dhe organizimin e mbajtjeve të mbledhjeve, seancave të kuvendit dhe të gjitha komiteteve si debatit me publikun, pjesa e fundit e vë në thonjëza, si "*debatit me publikun*", përveçse është formuluar gabim e do të duhej të ishte si dhe *debatet me publikun*, ne propozojmë që të hiqet krejt kjo, sepse Udhëzimi Administrativ për administratë të hapur, nr 04 \ 2023, neni 23 i këtij udhëzimi specifikon se debatet me publikun i organizon propozuesi ose iniciuesi i debatit dhe jo sektori për punë të kuvendit.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Nuk mund të hiqet ky opsion, për arsye se edhe kuvendi, inicion hartim të akteve të ndryshme p.sh ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për punën e kuvendit, andaj këtë proceduar do të duhej ta udhëheq sektori i kuvendit, pra të organizon debatin publik.

**Skender Behramaj, zyrtar i Komunës:** Ju kisha propozuar që ta lexoni Udhëzimin Administrativ për administratë të hapur, në nr 04/2023, neni 23 dhe pastaj diskutojmë. Sidoqoftë, vazhdojmë me piken tjetër të sektorit për punë të kuvendit te pika 2.2 e cila thotë: përgatit të gjitha materialet e nevojshme për takime të KPF-së, Komitetit për Komunitete, Kuvendi komunal, zyrës së kryesuesit të Kuvendit dhe takimeve konsultative të tjera. Propozoj që shkurtesa *KPF* të zëvendësohet me emrin adekuat që ka e që është *Komiteti për Politikë dhe Financa*. Pika 2.3 thotë: kujdeset që me kohë materiali i mbledhjeve të kuvendit komunal t'i dërgohet secilit anëtar të kuvendit komunal dhe të gjitha të drejtorive. Propozoj që kjo pikë të plotësohet edhe me emrat e institucioneve tjera të cilëve edhe jemi të obliguar t'ua dërgojmë materialin, siç është kryetari i komunës, ministritë përkatëse etj, sepse në qoftë se miratohet me këtë formulim, atëherë ne nuk jemi të obliguar me ja dërguar materialin as kryetarit as ministrisë. Pika 2.4, mbajtja dhe hartimi i procesverbaleve nga takimet e kuvendit komunal, komiteteve të kuvendit komunal si dhe komisionit për dhënie në shfrytëzim të pronës së komunës, propozojmë që në këtë pikë të shtohet, *takimet e kryetarit me qytetarë*, që janë dy takime në vit dhe të hiqet komisioni për dhënie në shfrytëzim të pronës së komunës, që të hiqet ky komision nga obligimi ynë si sektor për punë të kuvendit, sepse nga praktikat e deritashme procesverbalet dhe mbledhjet i organizon vet komisioni, ashtu siç bëjnë të gjitha komisionet që i formon kuvendi i komunës. Nëse do të ishte obligim i sektorit për punë të kuvendit thirrja, organizimi dhe procesverbali për këtë komision, atëherë do të duhej të ishte edhe për të gjitha komisionet tjera që i themelon kuvendi i komunës. Pika 2.5, të kujdeset që procesverbalet nga mbledhjet e kuvendit komunal, komiteti për politikë dhe financa, si dhe komiteteve të tjera, të publikohen në ueb-faqen e komunës. Propozojmë që kjo pikë dhe ky obligim të hiqet nga sektori për punë të kuvendit, pasi që, ne, në këtë sektor nuk kemi qasje në publikimet e dokumenteve në ueb të komunës. Kjo detyrë është e specifikuar te neni 18 i kësaj rregulloreje, sektori për komunikim dhe informim në piken 2.4 dhe në piken 2.5, ku thotë: përcjell të gjitha aktivitetet e kuvendit komunal dhe të kryetarit të komunës dhe kujdeset që t'i bëjë publike vendimet dhe qëndrimet e organeve komunale. Edhe njëherë, e tërë kjo kishte të bëjë me sektorin për punë të kuvendit ku unë shërbej. Ndërkaq, mendimet e mijë personale, propozimet për ndryshime dhe plotësimet, do t'i dërgoj me shkrim, në lidhje me rregulloren në përgjegjësi.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Të falënderoj shumë për kontributin, për propozimet, mirëpo, nëse veprojme ne sipas propozimit tuaj, atëherë sektorin për punë të Kuvendit duhet me shuar krejt, pra, ky sektor në rregullore duhet të parashihet të funksionon vetëm me zyrtar.

**Skender Behramaj, zyrtar i Komunës:** Më fal që ndërhyj, por prapë ju për mua mos ndryshoni asgjë, por këto bien ndesh me statutin e komunës, me rregulloren e punës së kuvendit.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** E nëse biem ndesh, ne po e lëmë veç zyrtarin, e ti ku do të mbetesh?

**Skender Behramaj, zyrtar i Komunës:** Për mua më mirë të bien ndesh, s'ka problem për mua.

**Xhavit Dauti, udhëheqës i Zyrës së Personelit:** A ka mundësi me jua dhënë fjalën së pari zyrtareve të gjendjes civile, sepse ata i kanë mbyllur zyrat?

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Po, veç t'i përgjigjem Skenderit. Në opinionin e datës 11 shkurt 2024 që e kam pranuar nga DMZP-ja, jam këshilluar ose m'i ndërruar detyrat ose m'i bashkuar

sektorin e kuvendit me sektorin ligjor bashkë, neve detyrat dhe përgjegjësit i kemi hartuar duke u bazuar në funksionin që kryen kuvendi. Ky hartim i detyrave është bërë me qëllim që askush të mos dëmtohet.

**Skender Behramaj, zyrtar i Komunës:** Kryesues, më fal edhe njëherë, kam përshtypje që nuk më ke dëgjuar absolutisht me vëmendje çka kam thënë deri më tani. Unë as nuk po dua me ndryshuar ligje, as rregullore. Propozimet e mija ishin për formulime të drejta dhe të mos bien ndesh me statusin e komunës, sepse kur të miratohet kjo rregullore, asnjë presje nuk mund t'ia heqësh.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Skender, jo, kjo mund të ndryshohet pas një muaji, mund të ndryshohet dhe plotësohet sa herë të ketë nevojë. Nuk është duke u miratuar njëherë edhe të mbetet gjithë jetën kjo, nuk është esenca e asaj pune, Skender. Komentet i jep me shkrim, i dërgon në email edhe në fund, pasi të përfundojë procedura e konsultimit, komisioni ulët, i bashkëbisedon edhe vendosim për këtë çështje, nëse pajtohesh edhe ti. Po, urdhëro?

**Adem Marmullaku, zyrtar i gjendjes civile në Jashanicë:** Përsëritet për të gjithë pjesëmarrësit! Lidhur me draft rregulloren e sistematizimit të vendeve të punës në komunën e Klinës, si zyrtar i gjendjes civile në komunën e Klinës, shprehi opinionin tim personal në lidhje me këtë projekt rregullore. Ligji i Pagave na ka diskriminuar skajshmërisht t'neve si kategoria e administratës, duke na lënë shumë ulët në koeficientin 3.92 që është një vendim i turpshëm. Natyra e punës dhe e një zyrtari të gjendjes civile, nuk mund të krahasohet me natyrën e një referenti të thjeshtë të shërbimit civil në komunën e Klinës. Një zyrtar i gjendjes civile, jo vetëm që merret me sistematizimin e të dhënave të qytetarëve në regjistrimet e lindjeve, martesave, vdekjeve, por ai kryen edhe punë të tjera. Shiqo, p.sh., raportimi i të dhënave për çdo muaji në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, regjistrimin e lindjeve që ndodhen jashtë shtetit, regjistrimin e martesave me shtetas të huaj, martesat e shteteve të Kosovës, regjistrimi i vdekjeve që ndodhin brenda Kosovës, regjistrimi i vdekjeve që ndodhin jashtë vendit, nxjerrja e certifikatave të ndryshme, lëshimi i vërtetimeve të tjera, etj. Them shkurt, nga gjendja civile, pjesë e së cilës jam edhe unë, lëshohen mbi 25 dokumente të ndryshme që kanë të bëjnë me të dhënat e qytetarëve të komunës së Klinës. Ne këto jua kemi dërguar edhe me email, po nuk e di sa merren parasysh këto kërkesa tona, për shkak të koeficientit tonë.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Secila kërkesë do të shqyrtohet me kujdes dhe nëse ka bazë ligjore do të merren parasysh. Edhe njëherë po ju them: caktimi i klasës së pagës nuk është kompetencë e kësaj rregullore, nuk është kompetencë e nivelit lokal. Caktimi i klasës së pagës sipas vendimit të datës 16.02.2023, Nr 04/128 është kompetencë e DMZP-së në bashkëpunim me thesarin, përmes formimit të komisioneve të përbashkëta, ata e caktojnë klasën e pagës për secilën pozitë. Edhe unë jam i pajtimit me ju se jeni të diskriminuar, neve së paku 6 kërkesa ja kemi drejtuar DMZP-së, me qëllim të ndryshimit të kësaj gjendje, por nuk kanë hasur në mirëkuptim nga ana e DMZP, pra, çdo here na janë refuzuar kërkesat. E thash edhe në fillim, se koeficienti nuk është cekur në rregullore, nuk e di ku e keni parë, askund koeficient nuk ka, për arsye se nuk ka kompetencë niveli lokal me caktuar klasën e ekuivalencës së pagës. Ne i kemi bërë në vazhdimësi këto vërejtje. Ju, këto komente është dashur menjëherë sa ka qenë rregullorja nr.06/2024 në konsultim publik, e cila në konsultim publik ka qenë deri më 7 shkurt 2024 në platformën e Kosova. Është rregullorja e nivelit qendror, kjo atje ka mundur të rregullohet, tek ne s'mund të rregullohet. Po, znj. Shehrije?

**Shehrije Millaku, udhëheqëse e Shërbimit Social:** Pasi që ju dëgjova me vëmendje dhe ishte fjala te koeficienti, edhe unë në Qendër për Punë Sociale ndihem e diskriminuar, për arsye se me emërimin e titullit të pozitës jam drejtuese e ulët, udhëheqëse e shërbimit të sektorit të shërbimeve sociale, titulli i pozitës është drejtuese e ulët, kurse në pagë jam profesional 1. Përderisa të gjitha qendrat tjera për pune sociale të dy udhëheqësit janë drejtues të ulët, e vetmja komuna e Klinës në regjion të Pejës, nuk po flas për komuna tjera, se ka që janë profesional 1, mirëpo janë edhe drejtues të ulët. Po flas për regjionin e Pejës, e vetmja komuna jonë është ajo e cila më ka diskriminuar në koeficient. Tash kjo nuk është fontanë dëshirash, por varet prej teje varet prej meje, përderisa respektohet ligji nëpër komuna tjera. Arsyeja është se, çka po ju shtynë ju që mos me respektuar ligjin këtu? Nuk jemi në gjykatë këtu, se si dhe pse, por ta kemi një respekt, jo diskriminim, jo vetëm diskriminim në institucion, po edhe diskriminim gjinor, kaq!

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Unë të falënderoj shumë për pyetjen! Do të mundohem t'i përgjigjem pyetjes tënde, edhe pse nuk varet prej neve çështja e caktimit të ekuivalencës së klasës së pagës, e thash edhe më herët. E nderuar ndoshta e dini së unë nuk e udhëheq DMZP-në, nuk jam pjesë e komisioneve të përbashkëta të themeluara DMZP, thesar. Për këtë arsye nuk kam ndikim në caktimin apo korrigjimin e ekuivalencës së pagave. Ju duhet të kupton së nivelin lokal, jo veç komuna e Klinës, po asnjë komunë nuk ka ndikim në caktimin apo korrigjimin e ekuivalencës së klasës së pagave. E di që e ke akt emërimin, *shefe e shërbimeve sociale*, mirëpo prej fillimi, DMZP/Thesar juve ju ka caktuar këtë koeficient (5.62). Ju kemi drejtuar DMZP-se në janar për herë të fundit, po kërkesa e jonë është refuzuar përsëri, neve nuk po kemi mundësi të ndikojmë, pra, s'po kemi mundësi të shtyhem me DMZP-në.

**Shehrije Millaku, udhëheqëse e shërbimit social:** Në regjionin e Pejës çka ka ndodhur, a kanë pasur bazë ligjore?

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Nëse ju kini dyshime në angazhimin tonë dhe jini e pa kënaqur me gjendjen aktuale, ju mund t'iu drejtoni organit kompetent për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në shërbimin civil, Këshillit të pavarur mbikëqyrës për shërbimin. Mirëpo pa hyrë në fuqi kjo rregullore, ti ankoresh kot, sepse ata ta hedh poshtë më pretendimin se ende nuk ka përfunduar procesi i sistematizimit.

**Altin Mujaj, zyrtar i gjeodezisë:** Përshëndetje së pari për të gjithë, faleminderit për këtë seancë sot të debatit për projekt rregullore! Unë desha të diskutoj këtë pjesën, pasi the këtë pjesën për regjion. Faktikisht jam i komunës së Pejës, përkatësisht jetoj në qytetin e Pejës edhe kam qenë pjesë e komunës së Pejës në praktikë 3 muaj edhe sa i përket pagave atje që paguhen gjeodetët me *bachelor*, janë me 6.56, dmth të klasifikuar si specialistë me kualifikim *bachelor*. Gjatë një takimi që e kemi pasur në komunën e Gjakovës, specialistët, gjeodetët, përkatësisht janë paguar si specialistë me 6.56. Unë kam bërë kërkesë ankesë në Këshill të Pavarur, edhe ata më kanë thënë që s'është bërë ende organogrami. Kështu që, nuk mund ta di ku mund të jetë problemi, për shkak se the për titullin e punës duhet me qenë zyrtar i lartë për me qenë specialist, titullin e punës që e përcaktoni ju fillimisht, kështu që, nuk e di se si ja kanë bërë komunat tjera, veç e di se në komunat tjera kjo funksionon edhe është duke funksionuar edhe kjo. Nuk është veç për këto komuna, por mund t'i merrni edhe si shembull këto komuna, me pyet si janë duke funksionuar te ta edhe të funksionojnë edhe këtu, se s'besoj se ka diçka ndonjë shkelje të ligjit që kanë bërë ata. Përkatësisht edhe komuna e Prishtinës ka hapur konkurs edhe konkursin që e

kanë hapur, *bachelor* kanë kërkuar si specialistë me 6.56 . Unë këtu e kam edhe shtojcën nr 10 të Ligjit të Pagave 08 Lfraksion, L196 edhe te shtojca nr 10, pika 10.6 është si specialistët në nivelin qendror në pozitën e fushave të planifikimit hapësinor, inxhinierisë, arkitekturës, urbanizmit dhe gjeodezisë, kimi, fizikë, biologji dhe fushat e tjera të ngjashme, janë të planifikuar si specialistë.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Unë në fillim e thash, që rregullorja është hartuar duke u bazuar në dispozita ligjore, të cilat i përmenda në fillim të këtij debati. Askund nuk e përmenda Ligjin për paga në sektorin publik, sepse nuk është në kompetencë e nivelit lokal për ta caktuar ekuivalencës e klasës së pagës. Kërkesën e juaj dhe të kolegëve të juaj i kemi dërguar në DMZP së paku 2 herë, DMZP-ja gjithëherë na i kanë refuzuar. Unë mund të them kështu: kërkesa e juaj është legjitime, e arsyeshme, mundësitë për të ndikuar në DMZP janë tepër të vogla, sepse ata janë organ mbikëqyrës i yni, jo ne mbikëqyrës i tyre. Vendimet e tyre mund t'i prish vetëm Këshilli i pavarur mbikëqyrës për shërbimin civil. Keni marr një përgjigje nga KPMSHCK-ja çfarë keni marr, edhe ai ju ka thënë se nuk ka shanse të shqyrtohet ankesa e juaj pa përfunduar procesi i sistematizimit në komunës e Klinës. Kur të hyjë kjo rregullore në fuqi, e fiton të drejtën, jo ju, por secili zyrtar ti drejtohet KPMSHCK-se. Vetëm atëherë KPMSHCK lëshohet në shqyrtimin e ankesës suaj, pra, e shqyrton se a ka bazë ligjore ankesa e juaj dhe a ka vepruar drejtë DMZP-ja, apo s'ka vepruar drejtë. Nëse ata konstatojnë se s'ka vepruar drejtë DMZP-ja, atëherë e anulojnë vendimin e tyre që ka të bëjë me caktimin e ekuivalencës së klasës së pagës dhe atë e zëvendësojnë me vendimin e Këshillit të pavarur mbikëqyrës për shërbimin civil. Pikërisht për këtë arsyeje është shumë me rëndësi të hyjë kjo rregullore në fuqi.

**Altin Mujaj, zyrtar i gjeodezisë:** Unë e përkrahi shumë rregulloren, është një punë shumë e mirë që po bëhet, e di që nuk është shumë e lehtë, nuk është asgjë personale, dmth kërkesat besoj që janë legjitime, janë të ligjshme. Siç e the edhe ti, DMZP-ja nuk e përcakton, dmth nuk dua ta gjej fajtorin a është fajtor DMZP-ja, apo ministria.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Dua ta lexoj çka thotë shtojca.

**Altin Mujaj, zyrtar i gjeodezisë:** Unë e kam lexuar çka thotë shtojca, e kam edhe ligjin këtu përpara.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Shtojca e rregullores për klasifikimin e pozitave të vendeve të punës, rregullorja nr 06/2024, e cila ka hyrë në fuqi më datë 28 shkurt 2024, e ka njohur si kategori të veçantë kategorinë e specialistëve. Ka përcaktuar së specialist do të kategorizohet zyrtari i cili mban pozitën e nivelit të lartë profesional me përgatitje specifike, të cilat kryejnë detyra që kërkojnë njohuri të thella profesionale, të natyrës komplekse ose specifike në mënyrë individuale ose si udhëheqës ose anëtar i një ekipi, si dhe punojnë të pavarur dhe pa mbikëqyrje dhe mbështetje profesionale brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektivat dhe afatet e përfundimit të detyrave. Zyrtari i cili kategorizohet të kategoria specialit, kryen detyra të cilat ndikojnë në punën e njësisë organizative. Kontribuojnë dhe kontrollojnë vendimmarrjen që si rregull ka pasoja kombëtare por përfshin edhe raste individuale. Kryerjen detyra dhe përgjegjësi në përputhje me udhëzimet e përgjithshme të udhëheqësit të tij dhe me një shkallë të konsiderueshme autonomie dhe vetë-iniciative. Kryejnë pune që paraqesin kompleksitet të lartë dhe nevojë për inovacion, si dhe mbështetjen profesionale për nëpunësit civil të nivelit më të ulët dhe mbikëqyrësit e tij në çështjet brenda fushës së përgjegjësisë së tij.

**Altin Mujaj, zyrtar i gjeodezisë:** Nëse e keni përfunduar të lutem a mund të vazhdojmë, vetëm t'i marrim gjërat me radhë, mos të dalim prej temës.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Vetëm të lutem për Ligjin e Pagave mos fol se nuk është çështje e shqyrtimit.

**Altin Mujaj, zyrtar i gjeodezisë:** Jo, kjo pjesa, a të flas për Ligjin e Pagave apo jo, jemi në diskutim dhe mendoj që e kam të drejtën time për të diskutuar.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** E ke të drejtën tënde të diskutosh për çka je thirrur, jo për çka s'je thirrur. Rreth përmbajtës së rregullores edhe në fillim e thash se në rregullore nuk figuron askund çështja e koeficientit apo e ekuivalenca e klasës së pagave. Ti mund të parashtrosh pyetje rreth asaj pse s'je klasifikuar specialist, po jo pse s'ma kanë caktuar koeficientin 6.52, sepse ky debat nuk është thirrur me diskutuar Ligjin për pagat në sektorin publik dhe as shtojcën e këtij ligji.

**Altin Mujaj, zyrtar i gjeodezisë:** Unë koeficientin nuk e përmenda asnjëherë, veç klasën e specialistëve.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Unë në fillim të këtij debati e thash se organi kompetent për caktimin e klasës së pagës sipas vendimit të datës 16 shkurt 2023, Nr.04/128 janë DMZP-ja dhe thesarit përmes formimit të komisioneve të përbashkëta.

**Altin Mujaj, zyrtar i gjeodezisë:** Dmth detyrat dhe përgjegjësitë e sektorit për Kadastër dhe Gjeodezi që thatë zyrtari i lartë duhet të ketë detyra dhe përgjegjësi, te detyrat dhe përgjegjësitë që i keni paraqitur, unë jua kam dërguar edhe me shkrim, disa prej detyrave nuk konsistojnë me ato pjesë që i kemi kryer ne, ka disa pjesë që janë harruar edhe që nuk janë shkruar. Unë e kam bërë një korrigjim në atë kuptimin me rekomandimin tim, kam menduar që është e drejtë edhe në bazë të punëve që i bëjmë, tek pjesa unë asnjëherë nuk e përmenda koeficientin, unë gjithmonë e kam përmend klasën e specialistëve.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Përshkrimi i detyrave të punës të zyrtarëve nuk figurojnë në rregullore, sepse ato pas përfundimit të procesit do të vendosen në formularin i cili quhet formular standard për përshkrimin e detyrave. Secila pozitë do ta ketë përshkrimin e detyrave në formularin standard për përshkrimin e detyrave të punës, atë formular kanë më nënshkruar udhëheqësi yt i drejtpërdrejtë dhe ju. Në këtë rregullore figurojnë vetëm detyrat e sektorit. Sektori është strukturë organizative, brenda tij mund të ketë zyrtarë të lartë, zyrtarë dhe zyrtar administrativ, varet prej organizimit.

**Altin Mujaj, zyrtar i gjeodezisë:** Dmth te Ligji 08L, fraksion 196, te ky Ligj edhe ti the që zyrtarët profesional 2 nuk kanë të drejtë të marrin vendime. Unë aktualisht si gjeodet, vazhdimisht çdo ditë marr vendime, dmth edhe kolegët e mi që tash ndoshta kanë dal në pension, disa prej tyre kanë vdekur, ka edhe 10 vite edhe akoma përmenden dmth vendime që merren prej tyre, dmth është temë shumë e ndjeshme që nuk janë vendime të zakonshme.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** A nënshkruan ju vendime, apo ato i nënshkruan drejtori?. A thuhet në shpalljen e konkursit kur ju keni konkurruar tek përshkrimin i detyrave të punës, se ju keni drejt me marr vendimi, me siguri se jo? Ju lutemi para se te parashtroni këso pyetje lexoni detyrat e punës të

pozitës zyrtar për kadastër dhe gjeodezi 2 dhe ju sugjeroj që ju t'iu përmbani atyre detyrave, sepse marrëdhënie pune me komunën e Klinës, kini krijuar, pikërisht ti kryeni detyrat që figurojnë në shpalljen e konkursit.

**Altin Mujaj, zyrtar i gjeodezisë:** Vendimin e nënshkruajmë bashkërisht me zyrën ligjore dmth Driloni që është profesional 3.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Sot po e kuptoj që Drilon Morina nuk koka asistent administrativ, por zyrtar ligjor dhe që DKGJP-ja paska zyre ligjore, kjo për mua është risi. Po befasona!

**Altin Mujaj, zyrtar i gjeodezisë:** Ryve Krasniqi, pra, dmth ajo e nënshkruan, me profesional 2 e nënshkruan aktvendimin edhe unë nxjerri aktvendime për ndarje kadastrale e të tjera.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Mbajtësit e pozitave të zyrtarit për kadastër dhe gjeodezi, të pozitave të zyrtarit administrativ, si dhe pozitave të asistentit administrativ, nuk kanë të drejtë të nxjerrin vendim, por vetëm të përgatitin drafte të vendimeve, sepse një gjë e tillë nuk ju figuron në përshkrimin e detyrave të punës. Kjo çka ka bërë Driloni, kjo është krejtësisht në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe cilësohet keqpërdorim i detyrës dhe autoritetit zyrtar me tejkalim të kompetencave. Driloni apo kush do tjetër këto vendimi i nxjerr në mënyrë vullnetare, por që nuk kanë kompetencë ligjore me nxjerre vendime të tilla.

**Rilind Millaku, zyrtar i Komunës:** Përshëndetje për të gjithë! Ende s'po mund ta kuptoj, koeficienti 3, 2, 1, a bëhet me kualifikim a në bazë të pozitës së punës?

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Në bazë të pozitës së punës, edhe është shumë me rëndësi për ta ditur ata që nuk kanë përgatitje adekuate profesionale çfarë kërkohet për pozitën që e mbajnë, dispozita përfundimtare e rregullore nr.06/224 ju mundëson më mbajte atë pozitë nëse gjatë tri viteve të fundit kanë treguar rezultate pozitive.

**Rilind Millaku, zyrtar i Komunës:** Këtu e keni p.sh., me kualifikim të njëjtë, njëri është 3, tjetri është 1 dhe 3shin p.sh., e ngarkoni me 10 kontrata të menaxherëve, e lshi s'bën asgjë, dmth këtu ka sa të duash shkelje.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Ajo është çështje administrative e drejtorit, nuk e rregullon kjo rregullore atë, është çështje e menaxherit, a kupton? P.sh., ti e ke drejtorin, udhëheqësin tënd, drejtori i juaj vendos për ato çështje që ju i ngritët.

**Rilind Millaku, zyrtar i komunës:** E në bazë të pozitës së punës, p.sh., unë si përgjegjës tash i automjeteve, s'jam asgjë kundër sigurimit, p.sh., unë barazohem me sigurim, i kam 100 përgjegjësi më shumë, edhe dmth unë barazohem prapëseprapë me sigurim.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Krejt në rregull është ajo, po është çështje për të cilën ka vendos nivelin qendror. Këtë problem mundet me zgjedh apo ndryshon vetëm niveli qendror dhe jo trupa punuese përmes kësaj rregulloreje.

**Rilind Millaku, zyrtar i Komunës:** Këtu për shembull ndërrohen akt emërimet pa i bërë gjashtë muaji, p.sh., zyrtari, dmth s'mund të emërohet një akt emërim për dikë tjetër ose për mua.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Edhe kjo çështje, nuk është objekt i kësaj rregullore. Vendimet për transferime sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi, i merr udhëheqësi më i lartë administrativ. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, bazuar në vendimet e udhëheqësit më të lartë i ndërron akt emërimit.

**Kristina Lazraj, zyrtare për trashëgimi kulturore:** Përsëritet për të gjithë, përsëritet për drejtorin e Financave, drejtoreshën e Kulturës, pasi janë prezent prej ekzekutivit. Unë në bazë të debatit që po zhvillohet këtu, unë nuk po dua të lëshohem tek pozita ime sepse komentet i kam dërguar me shkrim edhe çdo debat po m'është duket që veç kemi me humbur kohën edhe nuk kemi me ardhur në asnjë përfundim. Vërejtjet e mia janë së pari te anëtarët e komisionit, siç tha edhe Iliri më herët, për mos prezencë, e para, mirëpo edhe ne përbërje prej 7 anëtarëve të komisionit, mos me qenë asnjë përfaqësues prej Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dmth jemi e vetmja drejtori që nuk e kemi një përfaqësues që i dinë saktë punët dhe detyrat e sektorit tonë. Sa i përket gjërave tjera, po e di se s'është kompetencë e jotja, nuk dua të flas thash te pjesa e akt emërimit tim, detyrat edhe përgjegjësitë që i kam aty i kam dërguar, mirëpo unë veç një koment dua ta jap, që e tha më duket edhe parafolësi, *kur po duam po mundemi*, po ndërrojmë akte mërimë, po i vëmë në profesional 1, i vëmë zyrtarë të lartë. Ne e dimë, ka zyrtarë këtu që brenda vitit prej 3shit kanë dalë në 2sh, prej 2shit në 1sh. Ka këtu që brenda p.sh., i shoh drejtoritë këtu, secila drejtori i ka nga dy-tre profesional 1sha, ne nuk e kemi asnjë, nuk e di ligji si është, a çka është, edhe në bazë të disa gjërave unë tash duhet me propozuar ne me bërë edhe një teatër profesional edhe të sistemohemi tamam si e thonë edhe rregulloret edhe aktet tjera nënligjore që i kemi edhe ne. P.sh., zyra e trashëgimisë, e kulturës, e ku ta di unë, mirëpo nuk mund të jetë me një sektor p.sh., një udhëheqës edhe 2 profesional 1sha e diku me 12 punëtorë mos me qenë asnjë. Kemi dy zyrtare për Barazi, çka kishit bërë aty, nuk kemi p.sh., zyrtare për të Drejtat të Fëmijëve, kjo p.sh., në sektorin e juaj udhëheqës edhe dy profesional 1sha, se aty po bën 2 profesional 1sha te sektori juaj, e tek ne këndeju nuk bën. Dmth rregullorja është për t'i rregulluar këto gjëra, ti e di çfarë kompetencash kanë komunat te klasifikimi.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** A krahasohen përgjegjësit e zyrtarit të lartë të personelit me përgjegjësit e zyrtarit apo zyrtares të trashëgimisë kulturore?

**Kristina Lazraj, zyrtare për trashëgimi kulturore:** Përgjegjësia jote në krahasim me timen është shumë më e madhe, po përgjegjësia ime në krahasim me personin tjetër që ka qenë e që s'është më, e ka lëshuar vendin e punës, nuk krahasohet dhe është sistemuar profesional 1, edhe më herët ka kaluar në 7 apo 7.5, po ne jse.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Udhëzimi Administrative MPFT-01/2024 për rregullimin e konkurseve në sektorin publik, më datën 19 mars ka hyrë në fuqi. Ky Udhëzim organ kompetent për organizimin e konkurseve në sektorin publik (arsim dhe shëndetësi), e ka caktuar Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. Po ashtu, ka përcaktuar se pjesë perberese e komisionit të pranimit dhe e shqyrtimit të ankesave duhet të jetë përfaqësuesi nga NJMBNJ-ja. Unë nuk mundem me qenë pjesë e komisionit të pranimit dhe në të njëjtën kohë më qenë pjesë e Komisionit për shqyrtimin e ankesave, sepse paraqet konflikt të interesit. Andaj, për mëtejshmë situatave të tilla, kryetari i komunës zyrtarin e lartë ligjor të Drejtorisë për arsim, z. Elbarim Morina e ka transferuar në pozitën e zyrtarit të lartë të personeli në Drejtorinë për arsim, pra, nuk bëhet fjalë për pozitën e ish zyrtares së nderuar që edhe ju e potencuat se ka dhënë dorëheqje nga shërbimi civil. Nëpunësi i transferuar në

pozitën e zyrtarit të lartë të personelit edhe ma herët e ka pasur ekuivalencën e klasës së pagës të kategorisë profesionale 1.

**Kristina Lazraj, zyrtare për trashëgimi kulturore:** Nuk është mirë të flasësh me emër. Unë thash zyrtar, po emrin nuk ja përmenda, e para; e dyta; thash kur po duam t'i ndryshojmë, i ndryshojmë! I keni ndryshuar edhe më herët, prej 6 i keni kaluar në 7.5 ti e di, mos të hymë andej, mirëpo në këtë rregullore unë mendoj, këto mendime, këto propozime, duhet të merren parasysh edhe të bëhet njëfarë sistematizimi i barabartë për të gjithë, në qoftë se kalon pastaj në i kemi mundësitë tjera siç e the edhe ti, mundësitë ligjore me u ankuar në Këshill të Pavarur. Kjo s'është kompetencë e juaja si komision, e di, po është mirë t'i merrni parasysh këto sepse problemi është se kur po hapen vendet e punës po i shohim detyrat e punës, po ka pastaj mospërputhje edhe po ka shkelje në përcaktim të pozitës të akt emërimit, për atë duhet të kemi kujdes prej fillimit, si dhe çka po i japim detyrat e punës, si po e profilizojmë. Sa i përket grupit, unë personalisht në grup jam në rregull, kolegët tjerë mund të flasin për vete, ju faleminderit!

**Vlora Tafili, zyrtare për Informim:** Enver, veç një sqarim: sa i përket gjitha komenteve dhe rekomandimeve që janë dhënë këtu, unë si zyrtare përgjegjëse për konsultim publik, kemi m'i shqyrtuar një nga një edhe kemi m'i inkuadruar në draft.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Po më vjen keq, po ju nuk jini anëtare e grupit punues për me pasur mundësi më shqyrtuar komentet, propozimet apo rekomandimet që do i pranojmë.

**Vlora Tafili, zyrtare për Informim:** Jo, jo, unë do të jem si zyrtare përgjegjëse për konsultim publik, unë do të jem pjesë e grupit ku shqyrtohen komentet. Kjo rregullore nuk mund të miratohet pa u nxjerr raporti i konsultimeve publike.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Raportin e konsultimit e përgatitë trupa punuese, ashtu siç e kanë përcaktuar dispozitat e Udhëzimit Administrativ 04/2023 për transparencë në komun.

**Vlora Tafili, zyrtare për Informim:** Kjo rregullore do të shkojë me gjithë rekomandimet tona në kuvend, a miratohet apo s'miratohet, ajo pastaj i takon kuvendit komunal.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Nuk është çështje e imja, Vlorë, ajo, a miratohet apo s'miratohet nga anëtarët e kuvendit. Për mua është shumë më rëndësi auditori vitin e ardhshëm të mos gjejë shkelje, për shkak të neglizhencës së punës së trupës punuese të cilën unë e udhëheqë, pra, që komuna të mos ndëshkohet për shkak të neglizhencës time. Ky është qëllimi kryesor i imi, edhe nëse kalon në kuvend mos më pas probleme me kaluar ligjshmërinë.

**Vlora Tafili, zyrtare për Informim:** Atëherë, sa i përket këtij debati, definitivisht kërkesat e mia ka me i dorëzuar edhe njëherë me email.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Të propozoj më shfrytëzuar këtë të drejt, pra, të drejtën me i dorëzuar komentet e juaja përmes emailit. Trupa punuese, jo vetëm komentet e juaj, por secilin koment të pranuar do e shqyrtoj dhe ato do i inkorporoj në rregullore nëse kanë bazë ligjore. Drejtori, z. Enver Berisha, e ka fjalën!

**Enver Berisha, drejtor i DFEZH:** Faleminderit, kryesues i komisionit, përshëndetje për anëtarë të komisionit dhe gjithë të pranishmit! I vetëdijshëm për situatën që kanë kaluar shërbyesit civil në

komunën tonë që nga paslufta e këndeje, me krejt pakënaqësitë që i kanë pasur dhe me krejt, në njëfarë forme, jo kualifikimin çfarë është dashur me jua dhënë qysh me kohë, i vetëdijshëm që si komunë, ne gjithherë kemi qenë në raport me komuna tjera më ulët me çështjet e koeficienteve dhe pagesave, ne kemi llogaritur që Ligji mbi Pagat do të krijojë një bazë të mirëfilltë dhe do ta dërgoj në vend trajtimin e barabarte të zyrtarëve publikë, edhe për punën e njëjtë, dmth me qenë paga e njëjtë, por unë jo sa për të thënë. Por, e vlerësoj angazhimin e juaj si komision edhe e vlerësoj edhe mundësinë që keni startuar shumë herët me hartimin e kësaj draft-rregulloreje, për shkak që të ketë afat kohor deri në momentin e përfundimit të afatit ligjor, me dhënë vlerësime, me dhënë komente dhe mos me i mbetur borxh në njëfarë forme askujt që njerëzit i kanë pakënaqësitë e veta dhe m'i shfaq, po ashtu, besoj që edhe auditorët, që realisht ju si anëtarë të këtij komisioni duhet me marr krejt normale edhe me qenë të durueshëm dhe me i dëgjuar kërkesat me shqetësimet që këta i kanë, për faktin se tash ne jemi zyrtarë publikë dhe në njëfarë forme e dimë edhe krahasimin edhe situatën në komuna tjera. Unë po dua të besoj në ju si komision, që keni për t'i bërë përpjekjet maksimale me krejt mundësitë e bazuara në ligj, që me bërë përmirësimin e mundshëm për zyrtarë publikë të komunës sonë, sepse ky komision është i hartuar jo vetëm për hartim të rregullores, por edhe për mundësinë që në njëfarë forme ju me qenë të gatshëm në angazhimin e juaj me e bërë përmirësimin aty ku ka mundësi. Unë jam gjatë këtu edhe i di rrethanat e mëhershme edhe po dua m'i marr dy gjëra që këtu u ngritën bukur shqetësuese, e para; kjo nuk është fajti i atij komisioni dhe i kësaj rregulloreje që ne po e hartojmë, po dmth Ligji i Pagave dhe orientimet çfarë na vijnë prej së larti, ne e kemi pak problem me i ndërruar se realisht është një shkelje e rëndë që ka ndodhur me këta të zyrës se vendit, dmth me kaluar në atë nivel është vërtet shqetësuese, po meqë këta zyrtarët e Qendrës për Punë Sociale pak m'u përmend edhe në emrin tim po dua ta them edhe tjetrën, se realisht është një punë jo veç voluminoze që ka po është një punë që luan edhe me ndjenja që me njëfarë forme do edhe emocione. Përveç angazhimit realisht janë mbi 53-54 shërbime që ju ofron Qendra për Punë Sociale dhe është një punë e jashtëzakonshme që duhet me u bërë e unë i marr shqetësimet e tyre që brenda mundësive, brenda rregulloreve dhe brenda ligjit, që është mirë me ju dal në përkrahje dhe në angazhim, në mbështetje të këtyre zyrtarëve. Të paktën unë kam lutje për ju si anëtarë të komisionit, që krejt këto shqetësime, këto vërejtje që zyrtarët publikë i japin nga sektorët nga vijnë në një mënyrë mos me ju revanshuar në formën e përgjigjeve, dmth jemi duke bërë debat sot edhe ju me i marr kërkesat, shqetësimet dhe ju këto me i dorëzuar atje ku është vendi deri te situata kur vijnë në kuvend, se me siguri edhe kuvendi ka me i shqyrtuar dhe me i vlerësuar edhe me nxjerr pastaj një vendim në të cilën do të mbështet kjo rregullore, po unë po them kam lutje në pranimin e kërkesave, vërejtjeve, sugjerimeve, që zyrtarët do t'i japin, ju si komision me ju dal në hak punëtorëve, po mos të mbetet diçka si neglizhencë e juaja, si mosdashje e juaj, në njëfarë forme si mos punë e juaja, po realisht me dhënë maksimumin ju si komision edhe tash kjo koha që ka mbetur prapë me u konsultuar me udhëheqës të njësive, me drejtorë të drejtorive, me të gjithë që me i parë të gjitha mundësitë, që ky angazhim i juaj që unë e vlerësoj shumë, duke marr parasysh edhe njohjen profesionale që keni, që në njëfarë forme të vijë në vend krejt mundësia që ne e kemi si komunë, që të dal sa më mirë në hartim të kësaj rregulloreje dhe në njëfarë forme shqetësimet që duhet me i dërguar përtej komunës te DMZP-ja apo kudo qoftë, ju me bërë këtë veprim maksimal, që realisht zyrtarët publikë të komunës sonë të ndihen mirë së pari vet, por të ndihen mirë edhe me komisionet që i përfaqëson, edhe të ndihen mirë në udhëheqjen që e kanë, kështu që, po e them edhe njëherë në fund një lutje: maksimalisht me qenë në mbështetje të zyrtarëve komunal, faleminderit!

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Angazhimi imi personal dhe i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në këtë drejtim asnjëherë nuk ka munguar edhe falë angazhimit tonë, 80 % e zyrtarëve të komunës së Klinës, ju ka përmirësuar ekuivalenca e klasës së pagës. Po të kisha mundësi apo kompetencë për me caktuar ekuivalencën e klasës së pagës, asnjë zyrtar në komunën e Klinës nuk e kisha vendos nën klasën e pagës së kategorisë profesionale 1. Qëllimi i kësaj rregulloreje, është që pas miratimit (hyrjes në fuqi të saj) të saj, zyrtari i komunës së Klinës të paguhet njëjtë si zyrtarët e komunave tjera për punën që e bëjnë dhe për pozitën që e ka.

**Drilon Morina, asistent administrative 3 :** Përhëndetje për komisionin dhe për gjithë! U cek rëndësia dhe vendimmarrja që e marrin zyrtarët në lloje vendimesh, përgjigjen në kërkesa, dhe në bazë të asaj rëndësie përcaktohet edhe klasa dhe kategoria profesionale. Po flas për pozitën zyrtarë ligjor, këtu te ne, në Drejtori të Kadastrës është përcaktuar me profesional 2 zyrtari ligjor, që vendimet i nxjerr ai, pavarësisht edhe prej drejtorit, tash e atë që do të mundoheni t'i rregulloni sikur është edhe në komuna tjera, tash nuk po bëhet ky rregullim.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Drilon, ti je në proces të rekrutimit, shpresoj që i ke parë apo e ke lexuar përshkrimin e detyrave të punës, në shpallje të konkursit, aty shkruan cilat detyra ju duhet ti kryeni. Çdo veprim jashtë përshkrimit të detyrave të punës, pa autorizim më shkrim nga udhëheqësi i juaj i drejtpërdrejt konsiderohet tejkalim i kompetencave. Besoj që juristi duhet të paktën me ditë cilat janë pasojat kur tejkalohen kompetencat. Nëse nuk është në përshkrim të detyrave ju nuk guxon të nënshkruash vendim, përndryshe ti je duke kryer vepër penale, je duke i tejkaluar kompetencat. Pozita klasifikohet në kategorinë profesionale në bazë të asaj, se mbajtësit të pozitës a i lejon përshkrimi i detyrave të punës, të merr vendime, pra, ti nuk mundesh me pretenduar pozita e caktuar duhet me u klasifikuar në klasën profesionale 1, vetëm pse ju në mënyrë vullnetare merrni vendime. Ti ke të drejtë t'i refuzosh vendimet të cilat mendon se paraqesin vepër penale.

**Drilon Morina, asistent administrativ 3:** Zyrtari ligjor që përcaktohet me profesional 2, pse p.sh., merr vendime përgjegjësi, pse s'del në 1sh ai?

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Drilon, zyrtari ligjor sipas përshkrimit të detyrave të punës nuk i lejohej të merr vendimin, me sa kuptova unë, ju vendimet po i merrshi në mënyrë vullnetar. Nuk mund të klasifikohet pozita e zyrtarit ligjor në të njëjtën kategori profesionale, sikur pozita e Zyrtarit të Lartë Ligjor, sepse kanë detyra dhe përgjegjësi të ndryshme.

**Greta Skeli, zyrtare për Rrjet dhe Matje:** Përhëndetje, unë në fakt pata shumë pyetje, po nuk po shoh diçka përgjigje prej anës së komisionit, seriozitet të madh, as diçka serioze më saktë. Po kufizohem në dy pyetje: ne si ZKP, dmth zyra kadastrale komunale, sipas Ligjit për Kadastrë, neni 54, brenda një viti po kalojmë në agjencinë kadastrale, tash, a do të ishte mirë mos me u përfshirë ne në këtë rregullore fare, edhe me rregulluar agjencinë kadastrale këtë prej udhëzimeve, vendeve të punës, si thotë neni 54, dhe pyetja e dytë: u fol shumë për koeficientet, për përgjegjësi, për pozita, nëse ka mundësi dikush prej komisionit të juaj ta jap një përgjigje se si është e mundur që një zyrtar për fotokopje ta ketë koeficientin profesional 2 dhe një zyrtar për rrjet dhe matje dhe gjeometër që i ka të njëjtat përgjegjësi dhe detyra si zyrtari për kadastrë dhe gjeodezi, të kalojë në profesional 3?

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Zyrtarët e Drejtorisë së KGJP-së nuk mund të mos përfshihen në projekt rregulloren, sepse mos përfshirja në këtë projekt rregullore bijë ndesh me Statutin e Komunës

së Klinës deri sa ai nuk është ndryshuar dhe plotësuar. Dispozita e nenit 54, paragrafi 2 i Ligjit për Kadastër të Pronës së Paluajtshme, Nr. 08/L-237, në mënyrë shumë të qartë e ka precizuar se në afat prej një (1) viti nga dita e hyrjes në fuqi të ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit përkatës për Financimin e Pushtetit Lokal, AKK do t'i merr në kompetencë kadastrën nga njësitë e pushtetit lokal, si dhe tërë pajisjet dhe të punësuarit të cilët punojnë në kohë të pacaktuar në zyrat kadastrale komunale. Pra, sipas kësaj dispozite kompetencat mund të barten vetëm pasi që Kuvendi i Republikës së Kosovës të miratojë Ligjin për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit përkatës për Financimin e Pushtetit Lokal. Ju rikujtoj që ky ligje, ende nuk është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës edhe përkundër faktit që i njëjti në Platformën e konsultimeve publik ka qenë në konsultim publik nga dt. 16.07.2019 e deri me dt. 06.08.2019. Prandaj, zyrtaret e DKGJP-së deri në ditën që kalojnë nën menaxhimin e Agjencisë Kadastrale, konsiderohen zyrtar të Komunës së Klinës dhe duhen të përfshihen në Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Komunën e Klinës. Caktimi i ekuivalencës së klasës së pagës, sipas vendimit të qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 16.02.2023, Nr.04/128, është kompetencë e nivelit qendror. Pra, e Departamentit për Menaxhimin e Zyrareve Publik (DMZP-se) dhe Thesarit, përmes krijimit të komisioneve të përbashkëta. Caktimi i ekuivalencës së klasës së pagës nuk varet prej trupës punuese apo Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, sepse sipas vendimit të qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 16.02.2023, Nr.04/128, kjo kompetencë i është rezervuar nivelit qendror. Pra, neve jemi të detyruar ti zbatojmë vendimet e DMZP-se dhe Thesarit ashtu siç ata na janë dërgojnë.

**Drilon Morina, asistent administrativ 3 :** Po, Këshilli i pavarur, jo, DMZP, jo, ju jo, atëherë kush?

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Drilon, ne nuk jemi organi mbikëqyrës i DMZP-së dhe as i KPMSHCK-së, ne i zbatojmë vendimet e tyre.

**Drilon Morina, asistent administrativ 3 :** Nëse, nesër në ankesë të Këshillit të pavarur na kthejnë, ju e keni miratuar rregulloren të bazuar në rregulloren që është miratuar këtu, çka të bëjmë ne atëherë në bazë të kësaj rregulloreje që e keni bërë ju ? Ne prapë keq po mbesim.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Ti e ke konkursin e hapur, e ke parë që në atë konkurs titulli i vendit të punës është zyrtar ligjor dhe jo zyrtar i Lartë Ligjor, e thash edhe më herët se pozitës në mënyrë automatike Katalogu ja cakton klasën e pagës, ti mund të vish kur të duash në zyrën tonë, ne ta praktikojmë. Neve si njësi konkursin e kemi shpallur në bazë të kërkesës që na ka ardhur nga drejtoria e juaj, trupa punuese nuk mund të vepron në kundërshtim me kërkesën e drejtorit të drejtorisë ku ju jini i punësuar. Prandaj, në rregullore e ka paraparë pozitën e zyrtarit ligjor dhe jo të zyrtarit të lartë ligjor.

**Greta Skeli, zyrtare për Rrjet dhe Matje:** Këtu ka pasur njëherë një propozim, që zyrtari për rrjet dhe matje me qenë profesional 2, tash e keni ndërruar, e keni bërë profesional 3.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Deri më datë 28 shkurt ka qenë propozimi që të jetë profesional 2, edhe zyrtarët e gjendjes civile edhe krejt, po me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, pra, rregullores 06/2024, kanë ndryshuar gjerat, kjo rregullore dhe katalogu për titujt e vendeve të punës ka përcaktuar se zyrtarët për rrjet dhe matje - gjeometër, duhet të klasifikohet të kategoria profesional 3.

**Ilir Bacaj, drejtor i Qendrës për Punë Sociale:** Veç një kërkesë e pata: Meqë mua nuk më përket për Drejtorin të Arsimit, po ndoshta është dashur me paraparë një koeficient për zyrtar për Mbrojtje për të

Drejtat e Fëmijëve. Ju e dini që ky pozicion është i paraparë me Ligjin për Mbrojtje të Fëmijëve që ka obligative, në kuadër të Drejtorisë së Arsimit ka pasur shkresë edhe Zyra e Kryetarit prej Ombudspersonit, ku është kërkuar që një zyrtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve të jetë në kuadër të Drejtorisë së Arsimit, për shkak se DKA ka lidhje direkt me shkolla edhe normal duhet me qenë një zyrtar që i bashkërendon veprimet me Qendrën për Punë Sociale. Është mirë ta keni parasysh këtë se edhe parashihet në ligj edhe është kërkesë e Ombudspersonit, Zyrës së avokatit të popullit.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Është propozim shumë me vend, por mundësitë në aspektin ligjor dhe financiar nuk ekzistojnë.

**Taulant Berisha, zyrtar për Kulturë:** Atëherë, përshëndetje për të gjithë! Një mënyrë të rangimit të kategorisë e kam fjalën për Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, është renditur te grupi nr 63 e tema e këtij grupit është grupi i administrimit të përgjithshëm.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Taulant, e thash edhe më herët, pozita përcakton fushën e arsimit që kërkohet, pra çfarë përgatitje profesionale duhet të kërkohet, p.sh. Taulant Berisha...

**Taulant Berisha, zyrtar për Kulturë:** Nuk jam duke e anashkaluar, as nuk jam duke e ulur asnjë fakultet, po nuk ka të bëjë një person që ka kryer fakultetin juridik ose fakultetin ekonomik ose inxhinierinë, nuk ka të bëjë fare me kulturën, ai nuk mund të dijë çka kërkon kultura.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Taulant, a bën veç një shpjegim ta jap se tash po harrojmë, p.sh., zyrtari për kulturë, bën pjesë te profesional 2 dhe kërkohet një vit përvojë pune nga fusha profesionale, kandidati që konkurren nëse nuk ka përvojë pune nga kultura, ai diskualifikohet në procedurë paraprake, pra, nuk ka shancë të vijë deri te punësimi si zyrtar i kulturës, i një kandidat që ka p.sh fakultetin e gjuhës shqipe.

**Taulant Berisha, zyrtar për Kulturë:** Pse si bëhet konkursi pastaj?

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Në profesionale thotë, nëse zyrtari për kulturë kategorizohet të grupi i administrimit të përgjithshëm edhe kërkohet një vit punë profesionale nga fusha për të cilën ushtron zyrtari, diskualifikohet secili, ai me gjuhë shqipe, ai që nuk ka përgatitje, po këtë pyetje është dashur ta bësh sa ka qenë rregullorja nr.06/2024, për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil në konsultim publik.

**Taulant Berisha, zyrtar për Kulturë:** Po de po, po pastaj po ulet kriteri, janë pastaj personat që nuk kanë të bëjnë fare me fushën përkatëse.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Nuk më kuptove, Taulant. Hapet konkursi për pozitën zyrtar i kulturës, kandidati konkurren për më aplikuar në këtë pozitë duhet këtë një vit përvojë pune në fushën e kulturës, nëse kandidati nuk e ka një vit përvojë pune nga fusha e kulturës, atëherë ai në procedurë të verifikimit paraprak diskualifikohet, nëse konkurren p.sh., kandidati që ka përgatitje profesionale të gjuhës shqipe edhe nëse ka 20 vite përvojë pune si arsimtar, ai diskualifikohet për shkak se nuk e ka një vit përvojë pune nga fusha e kulturës. Këto rregulla në mënyrë të detajuar janë përcaktuara me dispozitat e legjislacionit në fuqi që e rregullojnë këtë fushë, nuk e di pse po bëni polemik. A ka edhe dikush?

**Alban Gashi, zyrtar për Kulturë:** Nuk isha këtu më herët, foli edhe Taulanti se kërkesën e kemi dërguar, Enver, e ke parë, dmth është çështja e arteve pamore, arti pamor i përfshin te grupi 63 i paspecifikuar, dmth për ne është një lloj denigrimi, i paspecifikuar te grupi ku na keni ndarë.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** I nderuar, shtojca nr.2 e rregullores nr.06/2024 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil, grupimin e pozitave e ka ndarë në 64 grup pozita. Në këtë shtojcë nuk ka grup pozitë të veçantë për kulturë, neve në mungesë të këtij grupi dhe pas konsultimit më DMZP-në juve ju kemi ranguar të grupi i administrimit të përgjithshëm. Grupi i Kuratorëve / muzeologjisë, nuk ka të bëjnë me zyrtar për kulturë asgjë, e thash edhe në fillim, grup pozita klasifikon në bazë të fushës arsimore që e kërkon pozita, dhe jo në bazë të përgatitjes që posedon mbajtësi i pozitës, se nëse ne rangimin e bëjmë në bazë të përgatitjes profesionale që posedon zyrtari, atëherë shumë lehtë munde të ndodh që dy zyrtarë mbajnë pozitën e njëjtë p.sh. të kulturës, të rangohen në dy grupe të ndryshme.

**Jeta Marmullaku, zyrtare e Depos 3 :** Në pozitën që jam pranuar ka qenë grupi arkiv i dokumentacionit, pse është ndërruar tash?

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Në kohën kur u jeni pranuar në punë, pozita e zyrtarit të Depos 3, është kategorizuar në kategorinë profesional 4 dhe është kërkuar përgatitja profesionale e shkollës së mesme, në atë kohë ka qenë në fuqi rregullorja 26/2020, ajo është shfuqizuar në vitin 2022, pra me 30 dhjetor 2022 ka hyrë në fuqi rregullorja e re me nr. 10/2022, tash përsëri është ndryshuar ajo, dmth ne nuk mundemi ta vazhdojmë si ka qenë në kohën kur ju jini pranuar, por duhet t'iu përshtatemi rrethanave aktuale, pra, dispozitave aktuale ligjore që rregullojnë rangimin e pozitave, për pozitën zyrtar i depos 3, kandidatit apo kandidatës në të ardhmen i kërkohej të këtë shkollim të mesëm. Pikërisht kjo ka qenë arsyeja pse pozita e zyrtarit të depos 3, është ranguar te grupi i administrimit të përgjithshëm që është listuar në nr 64 të shtojcës nr.2 të Rregullores nr.06/2024.

**Jeta Marmullaku, zyrtare e Drejtorisë për Kulturë:** Se edhe në mungesë të arkivistit, prej se kam hyrë, jam duke i bërë punët e arkivistit.

**Enver Mala, kryesues i trupës punuese:** Ju detyrat e arkivistës jini duke i kryeni në mënyrë vullnetar. Këtë çështje ju duhet ta zgjidhni më eproret e juaj!

Atëherë nëse askush tjetër nuk dëshiron me marr fjalën, unë ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje në dhe për kontributin e juaja në këtë debat publik! Po ashtu, ju rikujtoj së deri me datën 25 mars mund të dërgoni komentet, sugjerimet apo rekomandimet e juaj në emailadresën elektronik [enver.mala@rks-gov.net](mailto:enver.mala@rks-gov.net).

**Debati me publikun, përfundoj në ora 11:55**

Procesmbajtësja : Monika Palushi



Kryesuesi i trupës punuese: Enver Mala



